



**Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e
ish-Sigurimit të Shtetit**



**Instituti i Historisë së Europës
Mesdhetare të Kiliarit, Romës dhe
Milanos**

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI



Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Nr. 743 Prot. Datë 18.04.2023



**Instituti i Historisë së Europës
Mesdhetare të Kalliarit, Romës dhe
Milanos**

Nr. 1123 Prot. Datë 13.04.2023

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot, më datë 13.04.2023 në Tiranë, ndërmjet palëve të mëposhtme:

1. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), përfaqësuar nga znj. Gentiana Sula, Kryetarja e Autoritetit,

dhe

2. Instituti i Historisë së Europës Mesdhetare të Kalliarit, Romës dhe Milanos (ISEM), i përfaqësuar nga z. Gaetano Sabatini, Drejtor i ISEM.

Palët janë marrë vesh se për të realizuar qëllimin e përbashkët do të respektojnë dispozitat e kësaj marrëveshjeje të shprehura më poshtë.

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është vendosja e urave të bashkëpunimit në fushën e kujtesës, për rivlerësimin e personaliteteve dhe ngjarjeve historike, si dhe kontributi në njohjen e së shkuarës, për të rregulluar formalisht bashkëpunimin ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (më poshtë Autoriteti) dhe Institutit të Historisë Europiane Mesdhetare, pjesë e Këshillit Kombëtar Italian të Hulumtimit (më poshtë ISEM-CNR).

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është të përcaktojë rolin dhe përgjegjësitë e secilit institucion, për të arritur qëllimet e përbashkëta, për të hedhur dritë në historinë bashkëkohore të Shqipërisë dhe Italisë, nëpërmjet kërkimeve, botimeve, projekteve të përbashkëta,

Neni 2

Objekti

Objekti i kësaj marrëveshjeje është institucionalizimi i marrëdhënieve për bashkëpunimin e ndërsjellë të palëve në kuadër të kontakteve dhe diskutimeve mbi çështje me interes të përbashkët,

veçanërisht për shkëmbimin e njohurive, informacionit, ekspertizës dhe praktikave më të mira mbi arkivat, duke shkëmbyer po ashtu të dhëna mbi materiale arkivore dhe dokumente historike me interes të përbashkët. Përparësi do t'i jepet rishqyrtimit dhe riorganizimit të historisë mbi të përndjekurit politikë të diktaturës komuniste (1944-1991), si dhe të akuzuarve apo/dhe survejuarve si të lidhur me pushtimin fashist të Shqipërisë (1939-1943), duke përfshirë përndjekjen politike në Itali dhe Shqipëri gjatë diktaturave; shkëlqes së të drejtave të qytetarëve, duke iu referuar veçanërisht rindërtimit të paanshëm historik të njëres prej periudhave më të errëta të historisë shqiptare dhe asaj europiane.

Neni 3 **Baza ligjore**

Baza ligjore e kësaj Marrëveshjeje është ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 17 i Rregullores “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me Vendimin nr. 21, datë 09.05.2017, VKM nr. 93, datë 27.02.2019, “Për përcaktimin e tarifave dhe të pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, Rezoluta nr.11 “Për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri” (2006) dhe Rezoluta “Për dënimin e krimeve të komunizmit ndaj klerit, si dhe mirënjohjen e veçantë për rolin dhe veprimtarinë e klerikëve në mbrojtje të vlerave demokratike dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut” (2016), të Kuvendit të Shqipërisë, Rezoluta e Parlamentit Europian mbi rëndësinë e një kujtese të përbashkët europiane (2019) dhe parimet e Rrjetit Europian të Kujtesës dhe Solidaritetit.

Neni 4 **Të drejtat dhe detyrimet e palëve**

Në përmbushje të kësaj marrëveshjeje, Autoriteti dhe ISEM-CNR kanë të drejta dhe detyrime, dhe angazhohen të bashkëpunojnë në fushat e tyre të kompetencës dhe të misioneve të tyre, si më poshtë:

- a. Autoriteti dhe ISEM-CNR pranojnë se kanë ekspertizë plotësuese dhe interesa që shkojnë krahas njëri-tjetrit, - veçanërisht sa i takon rindërtimit të arkivave mbi emigrantët e persekutuar dhe liderët politikë, - për të plotësuar mungesën e të dhënave të sakta historike dhe për të mbështetur parimet e aksesit të hapur.
- b. Autoriteti angazhohet që të sigurojë dokumente arkivore pa pagesë për studiuesit e autorizuar nga ISEM-CNR, në kohë për projektet e tyre të përbashkëta ose planet vjetore të miratuara dhe shkëmbyera nga të dy institucionet, me qëllim që të hidhet dritë mbi të shkuarën e përbashkët, përmes kërkimit arkivor dhe rindërtimit të kujtesës.
- c. Po ashtu, ekspertë të kujtesës dhe/ose studiues do të bashkëpunojnë si ekspertë pranë Autoritetit, për projekte dy apo shumëpalëshe, duke analizuar dhe kryqëzuar të dhënat arkivore, duke bashkëpunuar për dëshmi, botime, hulumtime, etj.

- d. Autoriteti dhe ISEM-CNR do të punojnë në partneritet për të realizuar synimet e tyre strategjike, për të siguruar përfitime sa më të gjera për hulumtimin arkivor, për publikun e gjerë dhe komunitetet shkencore.
- e. Autoriteti dhe ISEM-CNR e kuptojnë rëndësinë e punës në një konsorcium/bashkëpunim, për të përmbushur interesat reciproke dhe ato të komunitetit ku bëjnë pjesë. Të dy institucionet janë të përkushtuara për të mbështetur studiuesit dhe projektet/programet aktuale dhe të ardhshme, përpjekjet e të cilëve shkojnë për bashkëpunimin për të arritur qëllimet përkatëse.
- f. Institucionet të respektojnë parimin e komunikimit të mirë me njëri-tjetrin, veçanërisht kur puna e njërit institucion mund të ketë ndikim në përgjegjësitë e tjetrit.
- g. Si Autoriteti, ashtu edhe ISEM-CNR do të përpiqen të lajmërojnë njëri-tjetrin sa më shpejt që të jetë praktike, për zhvillimet përkatëse brenda sektorëve respektivë.
- h. Autoriteti dhe ISEM-CNR do të mbështesin në mënyrë aktive njëri-tjetrin në zhvillimin e planeve dhe politikave të tyre strategjike dhe do të japin komente e këshilla nga departamentet dhe institucionet përkatëse, kur të jetë e nevojshme.
- i. Anëtarët/drejtimesit e lartë të të dy institucioneve, në nivel të lartë organizativ dhe operacional, të Autoritetit dhe ISEM-CNR do të takohen (edhe virtualisht) në bazë vjetore, për të diskutuar çështjet me interes të përbashkët dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.
- j. Takimet periodike do të mbështeten nga ndërlidhja e rregullt ndërmjet zyrtarëve, çdo tre muaj, ose sipas nevojës.
- k. Institucionet do të sigurohen për personat e duhur të kontaktit për çështje të veçanta dhe që detajet e kontakteve të mbahen të përditësuara.

Neni 5

Promovimi i bashkëpunimit

1. Autoriteti dhe ISEM-CNR do të inkurajojnë bashkëpunimin ndërsektorial ndërmjet palëve, do të eksplorojnë natyrën e mundësive kolektive dhe do të shqyrtojnë zgjidhje të prekshme për sfida të përbashkëta.
2. Të sigurojë një kuadër bashkëpunimi për identifikimin e qëllimeve dhe ambicieve të përbashkëta strategjike, edhe nëpërmjet projekteve/ programeve të përbashkëta të ardhshme dhe pjesëmarrjes së përbashkët në grantet europiane dhe ndërkombëtare.
3. Vizibiliteti i plotë i kësaj Marrëveshjeje bashkëpunimi do të arrihet në faqet zyrtare të internetit të të dy institucioneve. Marrëveshja do të rishikohet çdo pesë vjet (ose edhe më shpesh nëse është e nevojshme), për t'u përditësuar me projekte dhe aktivitete aktuale, nëpërmjet komunikimit formal (hard copy/fizik dhe virtual) ndërmjet partnerëve.
4. Mandati i ISEM-CNR është të hulumtojë, trajtojë, si dhe transferojë teknologji/inovacion mbi historinë e kulturat e Mesdheut dhe kufijtë e jashtëm të tij, në një perspektivë afatgjatë, nga Mesjeta, në epokën bashkëkohore.
5. Linjat kryesore të kërkimit kanë të bëjnë me historinë e shoqërive mesdhetare në këndvështrim të gjerë, me referencë të veçantë integrimin mes kulturave të zonës, të drejtat politike dhe civile; proceset migratore; studimi dhe përmirësimi i trashëgimisë kulturore, duke përfshirë arkivat në vendet e Mesdheut; kërkimi mbi gjuhët, letërsinë dhe gjeografinë janë gjithashtu pjesë e interesit dhe fokusit të kërkimit ISEM-CNR.
6. Në kuadër të kësaj Marrëveshjeje bashkëpunimi, ISEM-CNR ofron njohuritë dhe ekspertizën e vet për projekte/programe të përbashkëta kërkimore në fusha të ndryshme që

kanë të bëjnë me mbrojtjen e arkivave, katalogimin dhe ruajtjen e materialeve dokumentare.

7. Ata bien dakord të shqyrtojnë rrugët formale për shkëmbimin e synuar të njohurive mes tyre, gjithashtu përmes shkëmbimit të studiuesve, si dhe thirrjes së rregullt të tryezave të rumbullakëta dhe seminareve për të nxitur diskutimin dhe debatin rreth sfidave dhe mundësive të përbashkëta.

8. Autoriteti dhe ISEM-CNR bien dakord të inkurajojnë bashkëpunimin e zgjeruar mes arkivave, për koleksione kombëtare, europiane dhe ndërkombëtare, si dhe sektorët akademikë, qoftë përmes shkëmbimit të njohurive, nxjerrjes në pah të mundësive për palët e interesuara dhe lehtësimit të mundësive që inkurajojnë bashkëpunim të zgjeruar.

9. Autoriteti dhe ISEM-CNR ndajnë praktikat më të mira me grupet e tyre të interesit në fushat me interes të ndërsjellë, përmes studimeve mbi rastet/ngjarjet, publikimeve, simpoziumeve dhe shpërndarjes së materialeve audiovizuale mbi konferencat/organizimet e përbashkëta.

10. Autoriteti dhe ISEM-CNR bien dakord të hulumtojnë në mënyrë aktive për fusha të kërkimit të përbashkët, kur këto përshtaten me prioritetet institucionale dhe sferat që u interesojnë. Ata mund të autorizojnë projekte kërkimore bashkërisht dhe të angazhohen me komunitetet përkatëse, për të siguruar zbatimin dhe vizibilitetin maksimal të tyre.

Neni 6

Pronësia intelektuale

Të gjitha pronat intelektuale (intervista, dëshmi, filma, etj.) të zotëruara nga secila Palë para nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje do të mbeten pronë e vetme e Palës, e cila i ka në pronësi. Pronësia intelektuale e krijuar si rezultat i bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë në pronësi të përbashkët e të dyja palëve.

Palët i japin leje jo-ekskluzive, të revokueshme, pa pagesë, njëri-tjetrit, për të përdorur materialet (në çfarëdo lloj forme qofshin) në pronësi të secilit, në mbështetje të këtij bashkëpunimi.

Palët japin leje jo-ekskluzive, të revokueshme, pa pagesë njëra-tjetrës, për të përdorur logot e njëra-tjetrës në produktet e këtij bashkëpunimi.

Në raste të tjera të kërkesave mediatike apo studimore të ISEM, përtej projekteve të përbashkëta, aplikohet tarifa e vendosur me Ligjin funksional 45/2015 dhe me VKM nr. 93, datë 27/02/2019.

Neni 7

Kufizimet/Garancia

1- Palët nënkuptojnë se asnjë ndërhyrje në aktivitetet e secilës Palë nuk do të nënkuptohet si rezultat i kësaj bashkëpunimi.

2- Të dyja palët nënkuptojnë se ata nuk mund të përdorin ndonjë imazh ose përshkrime të dëshmimeve, intervistave, filmave, etj., në kuadër të projekteve të përbashkëta, për reklamim, as nuk mund t'i referohen Palës tjetër ose këtij bashkëpunimi në mënyrën që imponon miratimin ose sanksionimin nga ana e Palës tjetër ose të aktiviteteve të tyre.

Neni 8

Koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet palëve

- 1- Autoriteti dhe ISEM-CNR do të kërkojnë në mënyrë aktive të angazhohen me palët e treta dhe të interesuarit për të zgjeruar shtrirjen e aktiviteteve dhe bashkëpunimit të tyre.
- 2- Aty ku është e përshtatshme, ata do të kërkojnë të zgjerojnë gamën dhe shumëllojshmërinë e organizatave të përfshira në iniciativa të përbashkëta, për të maksimizuar ndikimin dhe dukshmërinë e tyre, ndërkohë që sigurojnë mbulimin e kostove për të gjitha palët e përfshira.
- 3- Ata gjithashtu angazhohen me aktorë/institucione kryesorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për të kuptuar drejtimit e politikave për kërkime të përbashkëta në të gjitha disiplinat dhe për financimin e kërkimit për përfitim reciprok.

Neni 9

Përmirësimet, Ndryshimet, Shtesat

1. Palët mund të bëjnë përmirësime, ndryshime dhe/apo shtesa në këtë Marrëveshje, bazuar në pëlqimin e tyre të ndërsjellë.
2. Çdo përmirësim, ndryshim dhe/apo shtesë do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e **Autoritetit dhe ISEM- CNR**, apo nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjnë në fuqi pas nënshkrimit të tyre.

Neni 10

Mirëbesimi

1. Autoriteti dhe ISEM – CNR do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë.
2. Palët duhet të mbajnë në mirëbesim dhe të përdorin sipas fushës së veprimit të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë Marrëveshje.
3. Vështirësitë e paparashikuara, mosmarrëveshjet ose mospajtimet që rezultojnë nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi do të zgjidhen nëpërmjet bisedave në mirëbesim, me negociata midis Palëve.

Neni 11

Afati i marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje do të lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar, me mundësi rishikimi çdo pesë vjet, ose çdo moment të kërkuar nga palët.
2. Marrëveshja mund të përfundojë nga secila Palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës tjetër, (të paktën një muaj përpara).
3. Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, palët do t'u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, përsa i përket informacionit të shkëmbyer përpara datës së përfundimit të saj.
4. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë për interpretimin ose përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet me konsultime ndërmjet palëve.

Neni 12
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Marrëveshja është hartuar në Tiranë, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në **Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit** dhe dy të tjera në depozitohen në **Institutin e Historisë së Europës Mesdhetare të Kiliarit, Romës dhe Milanos (ISEM)**.

Për

**Autoritetin për Informimin mbi
Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**


Gentiana SULA

KRYETARE



Për

**Institutin e Historisë së
Europës Mesdhetare të Kiliarit,
Romës dhe Milanos (ISEM).**

Gaetano SABATINI

DREJTOR I ISEM



nr. 743 prot. dt 18.04.2023

nr. 11231 prot dt. 13.04.2023

Memorandum of understanding (MoU)

between

**Albanian Authority on Access to Information of the
Former State Security Service (AIDSSH)**

and

Institute of Mediterranean European History (ISEM-CNR)

1. Intent and Purpose

The Memorandum of Understanding (MoU) maintains a formal framework for co-operation between Albanian Authority on Access to Information of the Former State Security Service (hereinafter Authority) and Institute of Mediterranean European History, part of Italian National Research Council (hereinafter ISEM-CNR).

It sets out the role and responsibilities of each institution and explains how they will work together to achieve their shared goals to shed light into contemporary history of Albania and Italy, through research, publications, mutual projects, etc., for an unlimited period, reviewed every five years.

1.2 Its purpose is to:

1.2.1 Facilitate contact and discussion on matters of common interest, particularly by sharing knowledge, information, expertise and best practice on archives, sharing data on records contained in the archives and historical documents. Particular preference will be given to reconstructing and organizing the history of those people persecuted at the time of Hoxha (1944-1991), and those accused or surveilled as involved with the fascist occupation in Albania (1939-1943), including common political persecutions in Italy and Albania during dictatorships; violation of citizens' rights with particular reference to rebuilding an impartial historical reconstruction of one of the most obscure period of Albania and European history.

1.2.2 Set out the basis on which the organizations will co-operate in respect to achieving their corporate aims and responsibilities;

1.2.3 Provide a framework for co-operation in identifying shared strategic aims and ambitions also through future joint projects/programmes and joint participation to European and international grants.

1.3 Full visibility of this MoU will be given on both institutions' websites. It will be reviewed every five years and more frequently if necessary, to update it to the current

projects, and activities, through formal communication (hard copy and virtual) among partners.

2. ISEM- CNR role and responsibilities:

ISEM-CNR mandate is to research, train, and transfer technology on the history and cultures of the Mediterranean and its external borders in a long-term perspective, from the Middle Ages to the contemporary age.

The main lines of research concern the history of Mediterranean societies in a broad perspective with particular reference to the integration between cultures of the area, political and civil rights and to migratory processes; study and enhancement of cultural heritage, including archives in Med-countries; research on languages, literature and geographies are also part of ISEM-CNR interest and research focus.

Under the scope of this MoU, ISEM-CNR offers its knowledge and expertise for common research projects/programmes under various fields of archives protection, cataloguing and preservation.

Tools will take into consideration existing data: finance, standards, usability, functionality, digital preservation tool systems and also, archives' networks.

The list is by no means exhaustive and will be updated to include any necessary scope of the partners of this MoU.

3. AIDSSH roles and responsibilities

Authority is an institution established in 2017, based on law 45/2015 for the right of information on documents of the former State Security of the Ministry of Internal Affairs of the Socialist People's Republic of Albania for the period 29.11.1944-2.01.1991. Authority performs its functions in a collegial manner. It has full independence in its decision-making, for access to records from public institutions and citizens, research institutes and media, in the regard of transitional justice, based on legality, protection of the public interest and national security, reconciliation and national unity, protection of the right to private life and personal data, also of classified information; transparency; cooperation among the state institutions; efficiency and effectiveness.

Under the scope of this MoU, Authority is committed to provide with no cost archival documents to the researchers authorized from ISEM-CNR, in time for their mutual projects or the annual plans approved and exchanged by both institutions, in order to shed light on our common past, through archival research and reconstruction of memory.

Also, experts of memory and/or researchers will collaborate as Authority's experts, for common projects, analyzing and crossing the archival data, collaborating for testimonies, etc.

4. Co-operation

4.1. AIDSSH and ISEM-CNR recognize that they have complementary expertise and overlapping interests, especially in relation to reconstructing the archives of persecuted migrants and political leaders to fill the gap of precise historical data and to support the principles of open access.

Authority and ISEM-CNR will work in partnership when delivering their strategic aims, to ensure the widest possible benefits to the archival research, for the general public and the scientific communities.

Authority and ISEM-CNR understand the importance of working in a consortium to satisfy mutual interests and interest of overall community. Both institutions are committed to support current and future researchers and projects/programmes, which endeavors are to co-operate and work together to achieve their aims.

More specifically:

4.2. The institutions are committed to the principle of good communication with each other, especially when one institution's work may have some bearing on the responsibilities or remit of the other.

Both Authority and ISEM-CNR will seek to alert each other as soon as practical, to relevant developments within their respective sectors.

4.3. Authority and ISEM-CNR will actively support one another in the development of their strategic plans and policies and provide commentaries and advices from their respective departments and institutions, when appropriate.

4.4. Senior members of both institutions, in high and operational level, of Authority and ISEM-CNR will meet (also virtually) on annual basis to discuss matters of mutual interest and the implementation of this MoU.

The periodic meetings will be underpinned by regular liaison between officials, on a quarterly basis or as and when required.

4.5. The institutions will ensure that it is clear who the appropriate contacts are for particular matters and that contact details are kept up to date.

5. Intellectual Property

All intellectual property owned by either Party prior to the collaboration shall remain the sole property of the owning Party. Intellectual property created as a result of the collaboration shall be jointly owned by the Parties.

The Parties grant a non-exclusive, revocable, royalty-free license to use each other's logos in furtherance of this collaboration.

6. Promoting collaboration

6.1. The Authority and ISEM-CNR will encourage cross-sector collaboration between respective stakeholders, will explore the nature of collective opportunities, and will examine tangible solutions to joint challenges.

They agree to examine the creation of formal routes for targeted knowledge exchange between members, also through the exchange of researchers, as well as convening regular round-tables and workshops to foster discussion and debate surrounding shared challenges and opportunities more widely.

The Authority and ISEM-CNR agree to encourage enhanced collaboration between the archives, for national, European and international collections, also academic sectors, whether through knowledge sharing, highlighting opportunities to their stakeholders, and facilitating opportunities to encourage enhanced collaboration.

6.2. AIDSSH and ISEM-CNR share best practices to their stakeholders in areas of mutual interest through case studies, publications, symposia and dissemination of video content arising from common conference series.

6.3. AIDSSH and ISEM-CNR agree to actively investigate areas of joint research, when it fits with their institutional priorities and areas of mutual interest. They will seek to commission

research projects jointly and engage with the respective communities, to ensure their maximum applicability and visibility.

7. Build networks of collaboration

6.1. Authority and ISEM-CNR will actively look to engage with third parties and stakeholders to enhance the reach and scope of their joint activities and collaboration.

Where appropriate, they will look to broaden the range and variety of organisations involved in joint initiatives, to maximize their impact and visibility, whilst ensuring cost-effectiveness for all parties.

They will also engage with key national and international stakeholders to understand policy directions for common research in all disciplines and for research funding for mutual benefit.

8. Term and Termination:

This MOU is effective upon the date of the latest signature in time (Effective Date) and shall continue for an unlimited period, reviewed every five years, or at a moment required by developments. Either Partner may terminate this MOU for convenience effective upon 30 calendar days' written notice to the other Party. Any controversy which might arise for the interpretation or content of this MoU will be solved through consultations between parties.

Place and Date XXX

Rome, 11-4-2023

On behalf of AIDSSH (full contacts name and surname) XXX, Legal rep. (role) XXX

Signature XXX

On behalf of ISEM-CNR Professor Gaetano Sabatini, Director

Signature XXX

G. Sabatini